



## THIRJA E DYTË PËR APLIKIM

### Grante për vetëpunësim

#### **Emri i projektit dhe referencat: 2020 / 419-482 MBËSHTEJA E PUNËSIMIT TË TË RINJËVE NË SEKTORIN E ENERGIJISË, Aktiviteti A.6**

Projekt “Mbështetja e Punësimi të të Rinjëve në Sektorin e Energjisë” është projekt i financuar nga zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë, i implementuar nga Business Support Center Kosovo në partneritet me Komunën e Fushë Kosovës nën kontratën e grantit 2020 / 419-482 të nënshkruar më 27.10. 2020, ka qëllimin e përgjithshëm për të rriturbpunësimin dhe perspektivat e qëndrueshme të punësimi për grupet në disavantazh, përkatësisht të rinjtë dhe gratë në sektorin e energjisë në Kosovë.

Në kuadër të projektit “Mbështetja e Punësimi të të Rinjëve në Sektorin e Energjisë”, aktiviteti A.6. që ka për qëllim t’i mbështes 10 startup idea apo/dhe biznese të reja individuale. Me këtë rast, BSCK hap thirjen e dytë për të rritur kokurueshmërinë dhe fton të gjithë personat të cilët plotësojnë kriteret e vendosura në udhëzimet dhe kushtet për aplikim, të aplikojnë për grante për vetëpunësim.

**Mënyra e aplikimit është online ku përfshihet plotësimin e Shtojces 1 (Annex1) dhe Shtojces 2 (Annex 2) dhe bashkëngjitja e shtojcave si dhe e dokumenteve të listuara më poshtë në formatin pdf (të skenuara):**

- Letërnjoftimi i aplikantit fizik apo perfaqesuesit ligjor për aplikime nga biznese ;
- Biografia (CV) e aplikuesit fizik apo Certifikata e regjistrimit të biznesit (për biznese të regjistruara);
- Certifikata trajnimi dhe dokumente shtesë që i konsideroni se mund t’i japin vlerë të shtuar aplikimit tuaj

Përparësi për të përfituar nga ky projekt do të kenë: gratë, të rinjtë e papunë, minoritetet, personat apo biznese të reja të cilët kanë ndjekur trajnimin në tre module elektrike, të organizuar nga BSCK.

Afati i fundit për aplikim: **30.06.2022.**

Aplikimet e pranuar nga thirja e parë e shpallur më 26.04.2022 do të vlerësohen nga komisioni i pavarur vlerësues ndërsa aplikuesit e njejtë të cilët ridërgojnë aplikimet brenda afatit të thirjes së dytë duhet të kenë parasysh që aplikimi në thirjen e parë do shpallet i pavlefshëm dhe do vlerësohet vetëm aplikimi i thirjes së dytë.

Aplikuesi duhet të paraqesë versionin elektronik të aplikimit në adresën e kontaktit: [info@bsckosovo.org](mailto:info@bsckosovo.org).

Çdo aplikim i marrë pas datës përmbyllëse të shpallur do të konsiderohet i pavlefshëm.

Për të shkarkuar format e aplikimit dhe për më shumë informacione vizitoni uebfaqen <https://bsckosovo.org/>.





## Projekti 2020 / 419-482, Mbështetje në punësimin e të Rinjëve në Sektorin e Energjisë, Aktiviteti A.6

### Kushtet dhe udhëzimet për aplikim Grante për vetëpunësim

#### Numri referues thirrës: EU 02/2022

Projekti “Support to Employment of Youth in Energy Sector” është projekt i financuar nga zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë, i implementuar nga Business Support Center Kosovo në partneritet me Komunën e Fushë Kosovës nën kontratën e grantit 2020 / 419-482 të nënshkruar më 27.10.2020, ka qëllimin e përgjithshëm për të rritur punësimin dhe prespektivat e qëndrueshme të punësimit për grupet në disavantazh, përkatësisht të rinjët dhe gratë në sektorin e energjisë në Kosovë.

#### Neni 1 – Objektivat e Thirrjes

- a. Grantet për vetë-punësim në kuadër të projektit Support to Employment of Youth in Energy Sector, kanë për qëllim inkurajimin e ndërmarrësve të rinj potencial Kosovar (nën moshën 25 vjeçare) që eventualisht të krijojnë vende pune nëpërmjet themelimit të bizneseve të reja.
- b. Me arritjen e objektivit të përmendur në Nenin 1.a., qëllimi i kësaj thirrjeje është që nëpërmjet granteve për vetëpunësim t’i kontribuoj ekonomisë Kosovare duke e nxitur zhvillimin e bizneseve të reja në sektorin e energjisë.
- c. Numri i total i granteve të parapara me këtë thirrje është 10, ku shumën maksimale që mund të financohet nga projekti është 5,000€ për një grant.





## Neni 2 – Aplikuesit e pranueshem/ Pjesëmarrësit

- a. Aplikuesit duhet të jenë individë nën moshën 25 vjeçare që jetojnë në rajonin e Prishtinës. Po ashtu Aplikuesit mund të jenë grup i formuar nga 2 apo me shume individe, moshë mesatare e të cilëve nuk duhet të kalojë 25 vjet.
- b. Aplikuesit mund të punojnë në grupe, mirëpo pjesëmarrësi zyrtar duhet të jetë individ apo njëri nga individët që e dorëzon idenë/planin. Ky individ do të shërbejë si person kontaktues gjatë gjithë procesi relevant.
- c. Personi kryesor që do ta dorëzon planin duhet të jetë banor i regjionit të Prishtinës. Anëtarët tjerë të grupit mund të jenë nga çdo regjion tjetër i Kosovës.
- d. Secili aplikues është përgjegjës i këtyre kushteve. Në qoftë se plani është dorëzuar si grup, përgjegjës për këto kushte është personi kontaktues apo perfaqësuesi zyrtar i grupit.
- e. Aplikuesit janë të obliguar të punojnë vet në planin e tyre të dorëzuar. Bashkëpunimi me firmat ekzistuese apo ndonjë organizatë tjetër të ngjashme është e lejuar.
- f. Favorizohen gratë, të rinjtë e papunë dhe minoritetet.
- g. Favorizohen aplikuesit të cilët kanë ndjekur trajnimin në tre module elektrike, të organizuar nga BSCK, në kuadër të projektit “Support to Employment of Youth in Energy Sector”.

## Neni 3 – Parashtrimet / dorëzimet

- a. Grantet për vetë-punësim në kuadër të projektit Support to Employment of Youth in Energy Sector, kanë për qëllim inkurajimin e ndërmarrësve të rinj potencial Kosovar (nën moshën 25 vjeçare) që eventualisht të krijojnë vende pune nëpërmjet themelimit të bizneseve të reja nën Nenin 2.a.
- b. Secili nga pjesëmarrësit individual apo grupor mund ta dorëzojnë një formë të shkruar. Materialet e dorëzuara mund të jenë në Anglisht / Shqip / Sërbisht. Të gjitha kontaktet do të bëhen nëpërmjet këtyre tri gjuhëve.
- c. Aplikuesit duhet të dorëzojnë konceptet e planeve të biznesit të kompletuara duke e përdorur formën e planit / konceptit, e cila mund të merret nëpërmjet web faqes së BSCK-se [www.bsckosovo.org](http://www.bsckosovo.org). Të gjitha kërkesat tjera lidhur me thirjen e hapur për Biznes Planet më të Mira mund të gjinden në webfaqe.
- d. Numri maksimum i faqeve të shkruara duhet të jetë 10 faqe (duke mos marr parasysh edhe dokumentet shtesë që mund të dorëzohen).
- e. Konceptet e planeve të dorëzuara duhet të kenë vlerë komerciale dhe inovative. Koncepti komercial ka të bëjë me vetë-qëndrueshmërinë e biznesit në pikëpamje afatgjate. Koncepti inovativ ka të bëjë me gjetjen e një zgjedhje të re për biznes, apo ka të bëjë edhe me gjetjen e një mënyre të re për të ofruar diçka çka ofrojnë edhe bizneset e tanishme. Koncepti inovativ duhet të ketë një përparësi dhe të arritur më të qartë kur krahasohet me produktet, shërbimet, dhe teknologjitë ekzistuese. Informatat shtesë lidhur me kriteret e zgjedhjes do të publikohen në webfaqën e BSCK-së [www.bsckosovo.org](http://www.bsckosovo.org).
- f. Aplikuesi duhet të jenë vetë zotues të konceptit, e cila do të thotë se dituria dhe/apo kualiteti themelor i kompanisë ekzistuese (jo me të vjetra se tre vjet) apo të biznesit të ri që do të hapet duhet të kenë pëlqimin e zotuesit(ve) për eksplotimin apo përdorimin e konceptit të biznesit të huaj. Kur të vijë faza e perzgjedhjes në fazën finale për Biznes Planet më të mira, aplikuesit të cilët nuk janë zotues të konceptit u kërkohet që të dorëzojnë një letër e cila duhet të nënshkruhet nga zotuesi i konceptit e cila vërteton që ju mund ta përdorni konceptin e huaj për aplikim për grante vetëpunësimi. BSCK nuk është e obliguar që të verifikoj dokumentet e dorëzuara në lidhje me korrektësitë e autorizuara dhe ligjore të të drejtave intelektuale të autorit/zotuesit.
- g. Personat apo organizatat të cilat kanë kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejt në përpilimin e planeve të biznesit duhet të kenë emrat në planet e dorëzuara.
- h. Procesi i aplikimit, kriteret e vlerësimit dhe zgjedhjes, kushtet, si dhe kërkesat tjera janë të publikuara në webfaqën e BSCK-së [www.bsckosovo.org](http://www.bsckosovo.org).
- i. Aplikacionet të kompletuara (me Konceptet të Plan Biznesit dhe dokumentacione percillse) duhet të dorëzohen para afatit të fundit më 4 prill 2022.





#### Neni 4 - Aplikimi

- a. Aplikuesit mund të aplikojnë vetëm para afatit të fundit të dorëzimit të planeve me 30 qershor 2022.
- b. Mënyra e aplikimit është online ku përfshihet plotësimi i konceptit të biznesit idesë Shtojca I (Annex 1) dhe Pro formes – Shtojca II (Annex 2) dhe bashkëngjitja e dokumenteve të listuara më poshtë në formatin pdf (të skenuara):
  - Letërnjoftimi i aplikantit fizik apo perfaqesuesit ligjor për aplikime nga biznese ;
  - Biografia (CV) e aplikuesit fizik apo Çertifikata e regjistrimit të biznesit (për biznese të regjistruara, jo më të vjetra se 3 vjet);
  - Çertifikata trajnimi dhe dokumente shtesë që i konsideroni se mund t'i japin vlerë të shtuar aplikimit tuaj
- c. Aplikuesit të cilët marrin mund ti dorëzojnë formën e kompletuar për aplikim e cila gjendet ne webfaqën e BSCK-së para afatit të fundit të përmendur në nenin 4.a. Komisioni vleresues nuk do t'i vlerësojnë planet e pa kompletuara sipas formës së dhënë në webfaqe. Po ashtu komisioni vleresues nuk do ti vlerësoj ato plane të dorëzuara pas afatit të fundit.
- d. Pjesëmarrësit duhet të pajtohen me kushtet e vendosura, dhe duhet të tregojnë se e kanë lexuar dokumentin e kushteve, dhe se pajtohen në mënyrë eksplicite me këto kushte të cilën procedurë duhet ta bëjnë nëpërmjet formës së aplikimit me konceptin e biznes planit e cila mund të merret ne webfaqe të BSCK-së.
- e. Aplikuesit mund ta dorëzojnë vetëm një formë të konceptit të Plan Biznesit. Çdo version tjetër (i përmirësuar) i dorëzuar pas dorëzimit të pare, edhe pse e dorëzuar para afatit të fundit, nuk do të merren parasysh për vlerësim nga komisioni vleresues.
- f. Pjesëmarrja / aplikimi është falas.

#### Neni 5 – Procedura e blerjes

Blerja e paisjeve dhe mjeteve do të realizohet dhe administrohet përmes një prodedure të hapur sipas rregullave të brendshme të prokurimit nga BSCK që janë në harmoni me rregullat e Bashkimit European. Procedurat e prokurimit do të fillojnë pas nënshkrimit të kontratës në mes BSCK-së dhe përfituesit.

#### Neni 6 – Shpenzimet e pranushme që do të financohen përmes thirjes

Përmes granteve të kësaj thirrje publike mund të financohen në formë të mjeteve dhe paisjeve, vetëm mjetet dhe paisjet të pranushme për realizimin konceptit të biznesit në sektorin e energjisë, në periudhën kohore të specifikuar me kontratë.

#### Neni 6.1 – Shpenzimet e pranushme

- a. Mjete apo pajisje që do të përmirësojë infrastrukturën e një paisje ekzistuese
- b. Pajisjet kompjuterike lejohen nëse janë të integruara mirë si pjesë e një paisje, që do të thotë se pa serverin e të dhënave, ose pajisje të tjera kompjuterike paisja nuk mund të vihet në funksion





## Neni 6.2 – Shpenzimet e papranushme

- c. Kostot e mirëmbajtjes së pajisjeve ose kostot e kontratës për mirëmbajtjen e pajisjeve.
- d. Pagat ose mëditjet
- e. Trajnimin e teknikëve të pajisjeve për të operuar pajisjet. Koncepti plani i biznesit duhet të demonstrojnë angazhimin e përfituesit/ve për të marrë përsipër përgjegjësinë e mirëmbajtjes dhe funksionimit të pajisjeve
- f. Kostot e instalimeve të pajisjeve
- g. Blerjen e pasiveve të përdorura/rinovuar

## Neni 7 - Konfidencialiteti

- a. Komisioni vlerësues, trajnerët, dhe anëtarët e organizatës të përfshirë në thirrje kanë qasje në konceptet e planeve të biznesit dhe për këtë qëllim të gjithë e nënshkruajnë “deklaratën e konfidencialitetit”.
- b. Personat të cilët e nënshkruajnë “deklaratën e konfidencialitetit” do të kujdesen me përgjegjësinë më të lartë për konceptet e planeve të biznesit, dhe to të garantojnë konfidencialitet më të lartë. Mirëpo, organizatorët nuk e marrin përgjegjësinë për keqpërdorim, vjedhje, anulimin apo humbjen e dokumenteve të dorëzuara, përpos në raste të pakujdesisë.
- c. Materialet e dorëzuara mbesin pronë e zotuesit ligjor. Aplikuesit pajtohen që materialet e dorëzuara nuk do të kthehen atyre dhe pranojnë se të dhënat e tyre personale do të përdoren për qëllime të statistikave të organizatës. Organizata mund t'i asgjësoj dokumentet vetëm pas një kërkesë të shkruar nga Aplikuesit.
- d. Fituesi/it e perzgjedhur marrin përsipër bashkëpunimin me organizatën për qëllime të konferencave të shtypit lidhur me ndarjen e shpërblimeve / çmimeve.

## Neni 8 – Organizata dhe Komisioni Vlerësues

- a. Grantet për vetë-punësim në kuadrin e projektit Support to Employment of Youth in Energy Sector, të zbatuara nga BSCK, si organizate implementuese, kanë për qëllim inkurajimin e ndërmarrësve të rinj potencial kosovarë (nën moshën 25 vjeçare) që të krijojnë vende pune nëpërmjet bizneseve fillestare.
- b. Komisioni vlerësues do të përbëhet nga; profesionistë të jashtëm dhe të panvarur si dhe ekspertë tjerë nga bizneset. Stafit i BSCK-së dhe ventualisht përfaqësuesi i donatorit do të kenë rol monitorues.
- c. BSCK do të bëjë kontrollin administrativ të të gjitha materialeve të dorëzuara para se të dorëzohen për vlerësim tek komisioni vlerësues. BSCK e mban të drejtën që t'i tërheq materialet e dorëzuara nga procesi i vlerësimit në qoftë se ato nuk janë të kompletuara ashtu siç parashtrahet në dokumentin për kushte.
- d. Komisioni vlerësues gjithmonë e rezervon të drejtën që të dis-kualifikoj ndonjë aplikues, pa marrë obligim që t'i tregojnë arsyet.
- e. BSCK e mban të drejtën që të shtyj apo ndërroj afatet e fundit të dorëzimit dhe procedurat tjera.
- f. Komisioni vlerësues do t'i vlerësoj materialet e dorëzuara bazuar në kriteret kryesore të përmendura në webfaqën e BSCK-së. Komiteti është plotësisht përgjegjës për zgjedhjen e fitueseve të thirrjes për biznes planet më të mira.
- g. Komisioni vlerësues mban të drejtën që të mos shpërblej me ndonjë çmim fare askënd apo mos shpërblimin me shumën totale të kërkuar nga aplikuesi. Një vendim i tillë duhet të përcillet tek aplikuesit me një komunikatë që i parashtron të gjitha arsyet e një vendimi të tillë.
- h. Nuk do të ketë letërkëmbim të rezultateve finale.





## Neni 9 – Fituesit e Thirjes

- a. Të gjithë Aplikuesit do të informohen lidhur me rezultatet dhe në qoftë se ka kërkesë ata do të lajmërohen edhe në mënyrë të shkruar.
- b. Përfituesit e mjeteve janë të obliguar të nënshkruajnë formën e pranimit të mjeteve dhe nuk ka të drejtë kurrsesi që ti dëmtoj “Mjetet dhe Pajisjet” nga mos kujdesi, që ta tjetërsoj, apo t’ia dhuroj dikujt tjetër në shfrytëzim, por ta mirëmbajë, t’i ruaj dhe t’i shfrytëzojë për nevojat biznesore të tij
- c. Përfituesi i “Mjeteve dhe Pajisjeve” është i obliguar që t’i mirëmbajë, të punoj me to dhe ta ketë në shfrytëzim së paku 1 vit, nga dita e nënshkrimit të kontratës. Nëse BSCK gjatë kësaj kohe konstaton se përfituesi i ka tjetërsuar, dëmtuar apo nuk i ka në shfrytëzim apo posedim mjetet e pranuar sipas kësaj kontrate, atëherë përfituesi obligohet ti kthej ato mjete tek BSCK apo eventualisht tek donatori i projektit apo të bëjë kompensimin e tyre.
- d. Përfituesi i mjeteve dhe paisjeve pajtohet që në afarë do lloj kohe, brenda periudhës 1 vjecare të cekur në nenin 7.c, t’i ofroj BSCK-së apo ndonjë personi të jashtëm të angazhuar nga BSCK, mundësinë për monitorimin dhe vlerësim e situatës së mjeteve të përfituara.

## Neni 10 – Detyrimet dhe Konfliktet

- a. BSCK nuk do të jetë e detyruar për ndonjë paraqitje lidhur me procedurat apo zgjedhjen e planeve të biznesit.
- b. BSCK nuk do të jetë e detyruar apo nuk e mban përgjegjësinë për humbjen e ndonjë plani të biznesit që mund të ndodh.
- c. Për çdo mosmarrëveshje të mundshme, të dy palët do të provojnë që të zgjedhin mosmarrëveshjen me një pajtim të dyanshëm. Në qoftë se është e mundur, mosmarrëveshja do të zgjidhet nga gjyqi kompetent në Kosovë.

## Neni 11 – Kriteri i Përfundimit

- a. Të gjithë Aplikuesit duhet të pajtohen me kushtet dhe konditat e thirjes para se të dorëzojnë materialet e duhura (apo në momentin e dorëzimit të materialeve dhe formës së aplikimit).
- b. Aplikuesi/t do të mënjanohen nga thirja dhe pjesëmarrja e mëtutjeshme nëse ai/ajo:
  1. Është nën moshën 18 vjeçar/e.
  2. Nuk i plotëson kriteret e pjesëmarrjes siç është parashtruar nën Nenin 1 dhe 2.
  3. Nuk ka dokumentacion të vlefshëm identifikues.
  4. Ka qenë fajtor i ndonjë veprimi kërcënues profesional të vërtetuar nga secila mënyrë që organizata mundet ta justifikoj.
  5. Ka qenë i/e dënuar për shkak të ndonjë sulmi apo fyerje që ka të bëjë me sjelljen profesionale nga gjykimi që ka forcën e veprimit të res judicata.
  6. Nuk ka plotësuar obligimet që kanë të bëjnë me pagesat apo kontribuimet sociale (taksave të nevojshme) në pajtueshmëri me ligjet e Kosovës.
  7. Është fajtor i ndonjë keq informimi në dhënien e informatave të gabueshme nën kushtet dhe konditat e thirjes, si p.sh. dhënia apo mbajtja e informatave apo prezantimi i informatave me qëllim të keq informimit, apo dhënia e fakteve të gabueshme që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e tij/saj.
  8. Në mënyrë direkte apo indirekte, ofron, premtion, kërkon rryshfet apo ndonjë formë tjetër të përfitimit të përparësisë në thirje. Aplikuesve nuk do tu jepet shansa apo tu kërkohet ndonjë formë e rryshfetit apo ndonjë forme tjetër për përfitim të përparësisë në thirje.





## MBËSHTEJA E PUNËSIMIT TË TË RINJËVE NË SEKTORIN E ENERGJISË

### BSCK

#### Grante për vetëpunësim

#### Kriteret e Vlerësimit

Grantet për vetëpunësim në kuadër të projektit Mbështetja e Punësimit të të Rinjëve në Sektorin e Energjisë, synojnë të inkurajojnë ndërmarrësit potencialë të rinj kosovarë (nën moshën 25 vjeçare) që eventualisht të krijojnë vende pune përmes themelimit të bizneseve të reja.

#### Kush i plotëson kriteret për aplikim?

Nën grantet për vetëpunësim janë të hapura vetëm për ata pjesëmarrës që kanë respektuar kushtet e përcaktuara në Kushtet dhe Udhëzimet për Aplikim.

#### Si duhet të duket plani juaj përfundimtar i biznesit??

Çdo individë ose grup mund të paraqesë një aplikim me shkrim përmes aplikimit elektronik. Pjesëmarrësit duhet të dorëzojnë planin përfundimtar të biznesit në lidhje me sektorin e enrgjisë. Ata duhet të përdorin formularët e aplikimit të ofruar nga BSCK.

#### Vlerësimi

Konceptet përfundimtare të biznesit vlerësohen nga komisioni i panvarur vlerësues i përbërë nga ekspertë të fushës, partnerët implementues të BSC Kosova dhe ekspertë të tjerë të biznesit. Parashtruesi kryesor i secilit koncept biznesi do të ketë mundësinë të prezantojë planin e tij/saj të biznesit përpara anëtarëve të jurisë dhe duhet t'u përgjigjet pyetjeve të bëra nga anëtarët e jurisë. Anëtarëve të jurisë do t'u kërkohet të vlerësojnë planet bazuar në gjasat e tyre për t'u bërë në të vërtetë baza e një biznesi të qëndrueshëm. Në konsideratë, nga ana tjetër, do të përfshihen edhe faktorë të tillë si:

- Rëndësia strategjike dhe inovacioni i planit të biznesit - (Fizibiliteti, analiza e tregut, potenciali për idenë, palët e interesuara dhe efektet spin-off);
- Qëndrueshmëria dhe profitabiliteti komercial – (Vlera realiste, inovacioni, efikasiteti, të ardhurat, periudha e kthimit, potenciali për financim shtesë);
- Efektet zhvillimore – (krijimi i vendeve të punës, fuqia punëtore e kualifikuar, transferimi i njohurive, ndikimi në standardet e jetesës, ndikimi në grupet e marginalizuara dhe kostoja e jetesës);
- Cilësitë personale/grupore dhe iniciativat sipërmarrëse – (motivimi personal, CV dhe personaliteti, njohuritë e demonstruara, përvoja, ekspertiza dhe njohuritë e sektorit). Pjesëmarrja në tre modulet elektrike, të organizuara nga BSCK, në kuadër të projektit “Mbështetja e Punësimit të të Rinjëve në Sektorin e Energjisë” do të ishte avantazh.





Funded by  
the European Union

### **Afati kohor për fazat procedurale të aplikimeve**

Afati i fundit për aplikime: 30.06.2022

Afati i fundit për vlerësimin e pranueshmërisë së aplikimeve dhe njoftimin e fituesve: 15.07.2022

Afati i fundit për të bërë ankesë: 26.07.2022

Afati i fundit për kontraktim: 29.07.2022

